



A.nr. 471/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.471/2026, të datës 24.04.2026, të parashtruar nga ankuesit H. K, M. R, A. J, G. Z Sh dhe V. K, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Avokat A. H nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.471/2026, e datës 24.04.2026, të parashtruar nga ankuesit H. K, M. R, A. J, G. Z Sh dhe V. K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 559, i datës 26.03.20026, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit H. K, M. R, A. J, G. Z Sh dhe V. K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*) më datë 24.04.2026, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit protokolli 559, të datës 26.03.20026, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2082/2026 të datës 24.04.2026 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimet e datës 08.04.2026; Formulari i shpenzimit të departamentit, divizionit dhe sektorit për vitin 2026; Akt Emërimin 06.03.2012 për ankuesin H.K; Vendimin me numër protokolli 559 të datës 26.03.2026 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës; Vendimin me numër protokolli 1245 të datës 11.06.2024 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës; Propozimin për funksionalizimin dhe klasifikimin e pozitave në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të datës 11.06.2024 nga Drejtori për Buxhet dhe Financa për Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës; Listën e të ardhurave personale për ankuesen A.J për vitin 2024, 2025 dhe 2026; Kopjen e ID-së së ankueses H.K; Formularin për ndryshime datës 01.07.2024 për ankuesen G.Z-Sh; Listën e pagave për ankuesen H.K për muajin janar, shkurt dhe mars 2026, si dhe janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor, të vitit 2025; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa i datës 11.06.2024; Kopjen e ID-së së ankueses G.Z-Sh; Kartelën e nëpunësit për ankuesen G.Z-Sh për vitin 2023, për vitin 2024, 2025 dhe 2026; Listën e shqyrtimit të pozitave nga DMZP datës 28.03.2023; Formularin për ndryshim për ankuesen G.Z-Sh datë 11.06.2024; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtare e Lartë për Paguesa datës 11.06.2024; Formularin për ndryshime për ankuesen G.Z-Sh e datës 30.03.2023; Kërkesë për ekuivalentim të datës 06.03.2023; Akt Emërimin e datës 01.09.2022 për ankuesen G.Z-Sh; Kopjen e ID-së së ankueses A.J; Akt Emërimin e datës 24.06.2021 të ankueses A.J; Formularin për ndryshime për ankuesen M.R të datës 01.07.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës të datës 11.06.2024 për pozitën Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit; Listën e pagave për ankuesen A.J për periudhën janar-dhjetor 2024; Listën e pagave për ankuesin A.J për periudhën janar-dhjetor 2025; Listën e pagave për ankuesen A.J për periudhën janar-mars 2026; Kopjen e ID-së së ankueses M.R; Akt Emërimin e datës 11.07.2016 për ankuesen M.R; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtare e Lartë për Kontabilitet datës 11.06.2024; Formularin për ndryshime për ankuesen M.R datës 01.07.2024; Listën e pagave për ankuesen M.R për periudhën janar-mars 2026; Listën e pagave për ankuesen M.R për periudhën janar-dhjetor 2025; Listën e pagave për ankuesen M.R për periudhën janar-dhjetor 2024; Kopjen e ID-së së ankueses V.K; Emailin e datës 29.03.2023 nga H.Gj për A.T, N.B dhe E.D; Emailin e datës 29.03.2023 nga N.B për H.Gj; Emailin e datës 29.03.2023 nga B.B për H.Gj; Konfirmim për përfundimin e konkurrimit datës 06.03.2023 për pozitën Arkëtar; Akt Emërimin e datës 06.03.2023 për ankuesen V.K; Konkursin RN00009022 të datës 13.05.2022 për pozitën Arkëtar; Kartelën e nëpunësit për ankuesen V.K për vitin 2023; Formularin për ndryshime për ankuesen V.K të datës 01.07.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Raportim Financiar i datës 11.06.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2026; Vendimin e datës 03.12.2024 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës për formimin e grupit të vlerësimit të klasifikimit të vendeve të punës; Formularin e Planit Individual të Personelit për vitin 2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesve **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se fillimisht ankuesja H.K, sipas Akt Emërimit me numër protokollit 170 të datës 06.03.2012 mban pozitën *Zyrtare e të Hyrave*, ankuesja M.R sipas Akt Emërimit me numër protokollit 769 të datës 11.07.2016 mban pozitën *Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Financiare*, ankuesja A.J sipas Akt Emërimit me numër 554 të datës 24.06.2021 mban pozitën *Zyrtare për Buxhet dhe Financa*, ankuesja G.Z-Sh, sipas Akt Emërimit me numër protokollit 760 të datës 01.09.2022 mban pozitën *Arkëtar*, dhe ankuesja V.K, sipas Akt Emërimit me numër protokollit 260 të datë 06.03.2023 mban pozitën *Arkëtar*, të gjithë në Komunën e Fushë Kosovës.

Tutje sipas shkresave të lëndës, Drejtori për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 11.06.2024, ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, që të merr vendim për organizimin dhe klasifikimin e pozitave për zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa bazuar në katalogun e pozitave në shërbimin civil, duke propozuar që ankuesja M.R të caktohet në pozitën *Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Administratë Komunale*, A.J të caktohet *Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Arsim dhe Shëndetësi*, H.K të caktohet *Zyrtare e Lartë për Financa*, G.Z-Sh të caktohet *Zyrtare e Lartë për Pagesa* dhe V.K të caktohet *Zyrtare e Lartë për Raportim Financiar*.

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, më datë 11.06.2024 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 1245, me të cilin ka lejuar klasifikimin/ngritjen e koeficientit për zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, bazuar në katalogun e pozitave në shërbimin civil, duke aprovuar ngritjen nga profesional 2 në profesional 1 dhe atë duke caktuar ankuesen M.R në pozitën *Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Administratë Komunale*, ankuesen A.J në pozitën *Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Arsim dhe Shëndetësi*, ankuesen H.K në pozitën *Zyrtare e Lartë për Financa*, ankuesen G.Z-Sh në pozitën *Zyrtare e Lartë për Pagesa* dhe ankuesen V.K në pozitën *Zyrtare e Lartë për Raportim Financiar*.

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, më datës 26.03.2026, ka nxjerr Vendim me numër protokollit 559, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr.124 të datës 11.06.2024, për ngritjen e koeficientëve për ankuesit,dhe ka lënë në fuqi akt emërimet paraprake të ankuesve, nivelin profesional të caktuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 559, të datës 26.03.2026, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, pretendojnë se vendimi është i padrejtë, i paqartë dhe konfuz, duke cenuar parimin e sigurisë juridike e për rrjedhojë është në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i kontestuar cenon parimin e të drejtës së fituar për ankuesit, pasi që pozitave të tyre janë klasifikuar nga kryetari paraprak i komunës, kështu që kjo e drejtë nuk mund të cenohet në mënyrë arbitrare siç ka rezultuar me vendimin e kontestuar, për me tepër ulja e koeficientit për palët ankuese cenon stabilitetin e marrëdhënies së punës së tyre. Tutje vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative kështu që si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij ligji, sepse i mungon pjesa arsyetuar dhe nuk është nxjerr mbi bazë të asnjë prove. Kërkojnë që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 1245 i datës 11.06.2024 i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës dhe të obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Fushë Kosovës që ankuesve të ju bëjë kompensim diferencës e pagës sipas koeficientit profesional 1 dhe atë nga data 26.03.2026.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesve, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit me numër protokolli 1245 të datës 11.06.2024, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, është lejuar klasifikimi/ngritja e koeficientit për zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, bazuar në katalogun e pozitive në shërbimin civil, duke aprovuar ngritjen nga profesional 2 në profesional 1 dhe atë duke caktuar ankuesen M.R në pozitën Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Administratë Komunale, ankuesen A.J në pozitën Zyrtare e Lartë e Kontabilitetit për Arsim dhe Shëndetësi, ankuesen H.K në pozitën Zyrtare e Lartë për Financa, ankuesen G.Z-Sh në pozitën Zyrtare e Lartë për Pagesa dhe ankuesen V.K në pozitën Zyrtare e Lartë për Raportim Financiar, e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, sipas këtij vendimi, faktikisht përveç ndryshimit të klasës profesionale për ankuesit nga klasa profesional 2, janë caktuar në klasën profesional 1, këtu ka ndodhur edhe ndryshimi i pozitive në raport me pozitën që kanë mbajtur ankuesit sipas akt emërimeve.

Përkitazi me këtë, sa i përket klasifikimit të pozitive, Kolegji i Këshillit, konstaton se pozitën e ankuesve sipas aktit të emërimit hyjnë në kuadër të pozitive të kategorisë profesionale të përcaktuar me nenin 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, respektivisht sipas nenit 15, është përcaktuar: *“1. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 Profesional 2 Profesional 3”*, pra sipas dispozitave ligjore në fuqi janë përcaktuar tri klasa në kuadër të kategorisë profesionale, ndërsa sipas shkresave të lëndës, të gjithë ankuesit përveç ankueses V.K (*e cila ka themeluar marrëdhënie punë sipas kategorisë profesional 3*) kanë themeluar marrëdhënie pune para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa koeficientët e pozitive e tyre janë ekuivalentuar sipas koeficientit të klasës profesional 2.

Nëse i referohemi procesit të klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i cili ndërlihet me një proces i përcaktuar sipas neni 18 dhe 22, ndërsa kompetent për klasifikimin e vendeve të punës është grupi i vlerësimi i cili themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit ndërsa miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, siç parashihet me dispozitat e nenit 23, 24, 25, 26 dhe 27 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: Neni 23, përcakton: *“1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri, Neni 24, përcakton: *Vlerësimi për klasifikimin e pozitive të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit, Neni 25, përcakton: 1. Grupi i vlerësimit për klasifikim themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. 2. Grupi i vlerësimit për klasifikim përbëhet nga një përfaqësues i NJMBNJ-së, dhe nga nëpunës tjerë civilë me përvojë në institucionin përkatës, Neni 26, përcakton: “1. Grupi i Vlerësimit për Klasifikim analizon dhe vlerëson pozitën, harton propozimin për klasifikimin e pozitive dhe paraqet për**

veprime të mëtejshme tek drejtuesi më i lartë administrativ të institucionit. 2. Pas miratimit nga drejtuesi më i lartë i administrativ i institucionit, propozimi përfshihet në draftin e Rregullores së organizimit të institucionit”, Neni 27, përcakton: “1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi”.

Pra sipas këtyre dispozitave, Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret të ankuesve sipas Vendimit me numër protokollit 1245 të datës 11.06.2024, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, nuk ka pasur asnjë proces të klasifikimit sipas dispozitave ligjore në fuqi, sepse kjo nuk ka qenë kompetencë e Kryetarit të Komunës, sikurse në kohën e nxjerrjes së këtij vendimi nuk ka qenë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e ku me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 1245 të datës 11.06.2024, është përcaktuar se klasifikimi/ngritja e koeficientit është bërë bazuar në katalogun e pozitave në shërbimin civil, ndërsa Katalogu i Vendeve të Punës në Shërbimin Civil është miratuar sipas Vendimit me Nr.08/226, të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht sipas provave të lëndës, më datë 03.12.2024 Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës ka nxjerr vendim për formimin e grupit të vlerësimit të klasifikimit të vendeve të punës në administratën komunale, mirëpo që sipas përgjigjes në ankesë procesi i klasifikimit të vendeve të punës në Komunën e Fushë Kosovës nuk ka përfunduar, pra është fakt i pakontestueshëm që grupi i klasifikimit të vendeve të punës është formuar pas nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 1245 të datës 11.06.2024, pra është edhe një fakt që Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës nuk ka pasur mandat dhe nuk ka bërë asnjë klasifikim të vendeve të punës. Po ashtu Kolegji i Këshillit, sipas provave të lëndës konstaton se sipas Formularit të Planit Individual të Personelit për vitin 2024, asnjë nga pozitat ku janë caktuar ankuesit sipas Vendimit me numër protokollit 1245 të datës 11.06.2024 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, nuk ishin të parapara.

Përveç procesit të klasifikimit, që e elaboruam si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit me numër protokollit 1245 të datës 11.06.2024 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, kemi edhe ndërrim të pozitave për ankuesit në raport me pozitat që kanë pasur sipas akt emërimeve, e për rrjedhojë sipas Kolegjit të Këshillit, në rast se nuk ka klasifikim të mirëfilltë të pozitave sipas dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, atëherë kalimi i nëpunësit civil nga një pozitë në një pozitë tjetër sikurse ka ndodhur me rastin e ankuesve, bëhet përmes procedurave të transferimit siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Pra Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimet si më sipër, vlerëson se Vendimi me numër protokollit 1245 i datës 11.06.2024 i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, ishte nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, kështu që lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, pra Vendimi me numër te protokollit 559, i datës 26.03.20026, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, konstaton se i njëjti është nxjerr sipas kompetencave të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa shfuqizimi i Vendimit me numër protokollit 1245 i datës 11.06.2024 i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës sipas vendimit të kundërshtuar me ankesë është në pajtim me nenin 53 paragrafi 1, nenin 55 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit,

konstaton se Vendimi protokollit 559, i datës 26.03.20026, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, përmban të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, arsyetimi i tij është në pajtim të plotë me nenin 48 të këtij ligji, e për rrjedhojë duke qenë se ky akt është plotësisht i ligjshëm pasi me këtë është kthyer ligjshmëria, i njëjti nuk plotëson asnjë nga kushtet e paligjshmërisë së aktit administrativ të përcaktuara me nenin 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesve nuk janë të bazuara.

Nga ajo që u tha si më lartë, e duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.471/2026, më datë 29/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Avokat A. H;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.